

L I G J
Nr.7798, datë 23.2.1994

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7573, DATË 16.6.1992 “PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE
TË PUSHTETIT LOKAL”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Pas nenit 30 shtohet neni 30/a me këtë përmbajtje:

“Në rastet e zgjedhjeve pjesore të parakohshme detyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t’i kryej:

Një komision zgjedhjesh ku bëjnë pjesë kryetari, zëvendskryetari, sekretari dhe anëtarët. Komisioni propozohet nga subjektet që marrin pjesë në zgjedhje, dhe çdo subjekt që konkuron përfaqësohet në mënyrë të barabartë. Kur numri i Komisionit del çift, shtohet një anëtar pa parti.

Ky komision ngrihet:

a) në rreth, kur ka zgjedhje për këshilltarin dhe kryetarin e komunës a bashkisë, me vendim të këshillit të rrethit;

b) në prefekturë, kur ka zgjedhje për këshillin e rrethit ose për anëtarë të tij, me dekret të presidentit.

Në këto raste anëtarët e komisionit kryejnë detyrën pa shpërblehen nga puna dhe shpërblehen në masën që caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.793, datë 8.3.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.